



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Shijak, më // /03/ 2026

PROJEKT-VENDIM

PËR

“MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS PËR BASHKINË SHIJAK”

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr.281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, me qëllim rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në Informacion , Këshillit Bashkiak Shijak i propozojmë;

PËR TË VENDOSUR :

1. Miratimin e përditësimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Shijak në përputhje me Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të miratuar me Urdhrin nr.281, datë 30.12.2025.
2. Programi i përditësuar i Transparencës është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i bashkëlidhet si Lidhja nr.1.
3. Programi i Transparencës të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shijak në seksionin “Programi i Transparencës”, si dhe në mjediset e caktuara për njoftimet publike në Bashki dhe njësitë administrative.
4. Programi i Transparencës të përditësohet rregullisht në përputhje me ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore përkatëse.

Adresa: Lagja “Erzen” Shijak, Tel: +35557122152,    site:    _shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Koordinator për të Drejtën e Informimit, specialisti IT dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Shijak.

JURISTE

Xhuana Keçi



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Denalda Hoxha



SEKRETARI I KËSHILLIT

Kozeta Doda



KRYETARI

Elton Arbana



Adresa: Lagja "Erzen" Shijak, Tel: +35557122152, ëebsite: ëëë_shijak.gov.al, e-mail: info@shijak.gov.al